

“Jeta Katolike” - një qieill i ri në botën shqiptare

Nga Gjekë Marinaj



Kushedi sa herë shqiptarët në përgjithësi dhe ata katolikë në vëcëti e kanë pyetur veten në heshtje, vallë ..., i mungon ndonjë gjë jetës katolike shqiptare? A ushtrohet me forcën dhe format e duhura kjo fe e mrrekullueshme? Ç'bëhet me të pas orëve të meshës? Ç'është mëkati në lidhje me futjen e së resë në katolicizëm. Me siguri shumica prej tyre, ashtu në heshtje, ia kanë dhënë vetes njëfarë përgjegje, por nuk jam aq i sigurt se ato janë të atij nivelit saqë të ngjallin një sadisfakcion të plotë në marrëdhënie me vvetvenen e tyre.

Vërtet, çfarë do të ishte përgjegja më e arrië e këtyre cështjeve e, si do të mund të arrihej ajo në kushtë ekzistuese?

Proceset e ndryshme shkencore, ekuilibri kohor midis jetës së pasivitetit dhe asaj moderne si dhe liberalizmi, shpeshherë joantik, e kanë bërë të domosdoshme njëfarë risimi në mënyrën e të jetuarit të katolikëve. Në fund të fundit feja ka kuptim të plotë vetëm te njerëzit, ka lindur për të shërbyer atyre dhe ekziston si tejcuese e njeriut drejt piedestaleve të përsosmërisë në kuptimin më universal të fjalës. Pra, siç dihet, edhe katolicizmi i ka konsideruar si të pranueshme disa ndryshime të vogla ideologjike-praktike në striktizimin e njohur të tij. Por këto ndryshime për dis besimtarë paraqitën me fytyrë të sfinkëshme, tek ca të tjerë si ekskluzivisht të papranueshme e për shumicën, fatmirësisht, si ecuri drejt një kompromisimit të nevojshëm midis ligjshmërisë fetare dhe realitetit.

Në këto rrethana lindi edhe revista “Jeta Katolike”. Nga njëra anë, Dom Pjetër Popaj si përgues kryesor i fjalës së Zotit tek sofa e katolicizmit, duke e analizuar pozicionin në të cilin ndodhet jeta e katolikëve shqiptarë, e gjeti si të paevitueshëm faktin se, zgjerimi i diapazonit kulturor në fushën e katolicizmit do të ishte nisma më efektiv efektive për

eleminimin e divergjencave të krijuara midis njerëzve dhe këndvështrimit të tyre ndaj barometrit të të genit katolik bashkëkohor. Nga ana tjetër si intelektual shqiptar, ai e hodhi vështrimin përtëj caqeve të të rëndomtës: bota e njeriut tonë nuk duhet cunguar vetëm në orbitat e edukimit fetar. Dom Pjetër Popaj e ndjen mirë se ne jetojmë në shekullin e universalizmit, synojmë universalizmin dhe patjetër duhet ta jetojmë atë. Pra, mbetet retorike pyetja po qe se ai mund të diktojë tek shqiptarët mungesën e një tribune kulturore më të hapur e më kuqimplote në shërbim të tyre. Dhe kështu lindi idea e krijimit të revistës “Jeta Katolike”.

Dhënja jetë e kësajë ëndrrë është një fenomen impresiv jo vetëm në sytë e katolikëve por në jetën e shqiptarëve në përgjithësi. Po sa arrin kjo revistë ta kompozojë këngën e vërtetë që lexuesit e saj e kanë marrë nëpër dhëmbë për kaq kohë me një melodi shprese thjesht monotone? Le të zgjatemi më posht pak përtëj apançës së kapakëve të saj: falë talentit të jozakonshëm të redaktorit e më tepër të poetit Luigj Çekaj, si dhe Dom Pjetër Popajt si nuhatës real i aftësive të Luigjit- të cilit ia lëshoi pa derte revistën, Këshillit botus dhe bashkëpunëtorëve të tjerë, revistën “Jeta Katolike”, ndonëse kaq e re në moshë, ka arritur të të na ngrej zërin e puplicistikës shqiptare në një nivel të ri.

Në brendësinë e kësaj reviste, ku meritën kryesore do t' ia dedikoja redaktorit të saj zotit Çekaj, shpaloset një ndërthurje e shkëlqyer temash, një kompozim real i trajtimit të problemeve sociale me të cilat ballafaqohet lexuesi isaj, një fuqi magjike, e paparë në shumë revista e gazeta tjera, e cila mbërrin deri aty sa t'

ia mbajë të bymuer gjendjen shpirtërore lexuesit për shfletimin me emocion nga njëra faqe e saj tek tjetra. Aty duket qartë gjuha e betimit të pazëshëm për t' i sjellë lexuesit pasqyrën e zgjeruar të vetë ndjenjave dhe të shqetësimeve të tyre me zgjedhjen më të arrië, me të menduar, me efikase.

“Jeta Katolike” është një organ me përmasa të mëdha edukuese jo vetëm në fushën e fesë, letërsisë, politikës, historisë..., por edhe në fushën shpirtërore të secilit lexues të saj. Ajo ka forcë depërtuese të futet dhe të ndryshojë diçka në brendinë individuale të tjetrit. Pra di të mësojë të duash dhe të respektosh jo vetëm Zotin e madh, por edhe veten dhe njerëzit që jetojnë rrëth teje. Tek e fundja, kush nuk e do veten dhe të tjerët, nuk e njeh mirë as Zotin, ngaqë Zoti është dashuria më e pathyeshme në ecurinë e përditshme të njeriut. Me pak fjalë, kjo mikro-enciklopedi letrare, është një galaktikë që ka krijuar fytyrën e vet, sistemin e vet të të komunikuarit, formën e vet dritëdhënësë, përmasat e vlerave të veta të pamatshme e më e rendësishmja, gravitetin e duhur për t'u kuptuar lehtë prej secilit.

**LODINO STONE
COMPANY, INC.**

MANUFACTURERS OF CAST STONE, CONCRETE AND WOOD PARK BENCHES, PLAYGRAND EQUIPMENT

BILL LONDINO
PRESIDENT
TEL. 718/ 324-1439
FAX. 718-994-1760
3621 PROVOST AVE.
BRONX, NY 10466